

# MANUALI

## PËR QASJEN E PERSONAVE TË VERBËR DHE ME SHIKIM TË DOBËSUAR NË NGJARJE KULTURORE

MANUALI  
PËR QASJEN E PERSONAVE TË VERBËR  
DHE ME SHIKIM TË DOBËSUAR  
NË NGJARJE KULTURORE



© **Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis**


Autore: Mimosë Musliu  
Rudina Xhokli

Ky Manual është botuar në kuadër të FemArt 12. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Qendrës për Art dhe Komunitet - Artpolis dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret për të pasqyruar pikëpamjet e donatorëve tanë.

Prishtinë, 2024

# MANUALI

## PËR QASJEN E PERSONAVE TË VERBËR DHE ME SHIKIM TË DOBËSUAR NË NGJARJE KULTURORE



# Tabela e përmbajtjes

<b>Parathënie</b>	<b>5</b>
<b>Rreth artpolis – qendra për art dhe komunitet</b>	<b>6</b>
<b>1. Qëllimi i manualit</b>	<b>7</b>
<b>2. Vështrim i përgjithshëm dhe analizë e gjendjes ekzistuese e komunitetit të personave të verbër dhe me shikim të dobësuar</b>	<b>8</b>
<b>3. Korniza ligjore</b>	<b>10</b>
<b>4. Rekomandime për mundësi të barabartë dhe gjithëpërfshirëse</b>	<b>13</b>
4.1 Hapësirat	14
4.2 Rrugët hyrëse - dalje të qarta:	16
4.3 Sinjalistika e qartë për orientim	17
4.4 Udhëzues zëri	19
4.5 Ulëse të qasshme	19
4.6 Audio përshkrimi i ngjarjeve të ndryshme kulturore	20
4.7 Shkronja të zmadhuara	21
4.8 Ekspozita taktile	22
4.9 Webfaqe e qasshme	23
4.10 Hapësirë e qetë (zona pushimi)	23
4.11 Ndhma dhe shërbimet e ndihmës	24
4.12 Teknologjia e përshtatshme	24
4.13 Hartat prekëse	26
4.14 Teknologjia e realitetit të shtuar (ar)	27
<b>5. Përmbledhje e rekomandimeve për grupet e synuara</b>	<b>28</b>
<b>6. Shembuj të suksesshëm nga rajoni dhe bota</b>	<b>29</b>
<b>Përfundim</b>	<b>32</b>
<b>Bibliografia</b>	<b>33</b>

## Parathënie

Qasshmëria në institucionet kulturore është thelbësore për të siguruar që të gjithë individët, pavarësisht nga aftësitë e tyre fizike, mendore ose sociale, të kenë mundësinë të përjetojnë dhe të marrin pjesë në kulturë. Të gjithë kanë të drejtën të përjetojnë dhe shijojnë artin, por jo të gjithë mund të marrin pjesë në ngjarje artistike e kulturore për shkak të aftësive të kufizuara. Për shembull, individët e verbër dhe me shikim të dobësuar nuk mund të vlerësojnë pikturat në galeri, nuk mund t'i ndjekin shfaqjet teatrale në teatër dhe filmat në kinema dhe televizion pa përshkrime audio.

Qasshmëria në këtë kontekst nënkupton krijimin e kushteve dhe adaptimeve të nevojshme për të siguruar që të gjithë individët, pavarësisht nga aftësitë e tyre, të kenë qasje të barabartë në përvojat kulturore. Kjo përfshin përshkrimet audio për veprat e artit, shfaqjet teatrale dhe filmat, si dhe adaptimet e tjera të mundshme për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara. Vetëm kështu mund të sigurojmë që kultura të jetë me të vërtetë gjithëpërfshirëse dhe e arritshme për të gjithë.

Qasja e barabartë në kulturë është thelbësore për një shoqëri më të drejtë dhe më të integruar. Këtu janë disa arsye pse është kaq e rëndësishme:

- **Barazia dhe Drejtësia Sociale:** Të gjithë individët duhet të kenë mundësinë të përjetojnë kulturën në mënyrë të barabartë sepse qasshmëria siguron që asnjë grup të mos jetë i përjashtuar nga përvoja kulturore. Po ashtu, promovohet gjithëpërfshirja e cila shërben si mjet për të thyer barrierat që mund të përjashtojnë këtë komunitet të shoqërisë nga përfshirja e plotë në ngjarje kulturore.
- **Zhvillimi Personal dhe Edukimi:** Institucionet kulturore si; Muzetë, Bibliotekat dhe Teatrot luajnë rol të rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin personal të individit, kështu që qasshmëria e plotë siguron që të gjithë të kenë mundësi të mësojnë, të zhvillojnë kreativitetin dhe të përfitojnë nga pasuritë kulturore.
- **Përfshirja Sociale:** Institucionet kulturore që janë të qasshme për të gjithë kontribuojnë në një shoqëri më të përfshirë dhe më të bashkuar. Ato ofrojnë hapësira ku njerëzit nga sfonte të ndryshme mund të takohen, të ndërveprojnë dhe të ndajnë përvoja.
- **Zgjerimi i Audiencës:** Institucionet që investojnë në qasshmëri shpesh tërheqin një audiencë më të gjerë dhe më të larmishme. Kjo, jo vetëm që rrit ndjekjen dhe mbështetjen për këto institucione, por edhe promovon angazhimin qytetar, përmirëson e pasuron përvojën kulturore për të gjithë pjesëmarrësit.
- **Ndërgjegjësimi dhe Ndjeshmëria:** Institucionet që angazhohen në praktika të qasshme ndihmojnë në ngritjen e ndërgjegjësimit dhe ndjeshmërisë ndaj nevojave të ndryshme të individëve në shoqëri. Kjo mund të nxisë një kulturë më të mirëkuptueshme dhe të kujdesshme.

# RRETH ARTPOLIS

## Qendra për Art dhe Komunitet

Artpolis është organizatë joqeveritare që përmes kulturës, artit, edukimit dhe dialogut social ndikon në komunikimin dhe transformimin pozitiv të bashkëjetesës në komunitet.

E themeluar më 2004, vizioni i Artpolis është të krijojë një shoqëri të bazuar në vlera femi-niste në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Misioni i Artpolis është të ndërtojë fuqinë kulturore të grave dhe të rinjve për t'u bërë inspirimi dhe ndikimi i shoqërisë për ndryshim. Vlerat e Artpolis janë: feminizmi, barazia gjinore, drejtësia, paqja, edukimi, fuqizimi, emancipimi, hu-manizmi dhe besnikëria.

Artpolis identifikohet lehtë si një ndër organizatat unike, e cila e përdorë teatrin dhe for-mat e tjera artistike për të afirmuar, avokuar, edukuar dhe promovuar të drejtat e grave, të drejtat e njeriut, të drejtat e grupeve të marginalizuara, barazinë gjinore, komunikimin me komunitetet multietnike, ndërtimin e paqes, fuqizimin e grave dhe të rinjve e të rejave. Ky aktivizëm artistik e bën të veçantë organizatën Artpolis, më afër qytetarëve, dhe ndërton relacione të sigqerta e më të fuqishme në komunikimin e përbashkët me komunitetin, duke gjetur përkrahjen e tyre. Ajo çka e dallon Artpolis-in nga organizatat e tjera joqeveritare është bashkëpunimi kreativ dhe edukativ me të rinjtë/rejat në nivel të lartë, përkrahja e komuniteteve pakicë, gjithëpërfshirja, diversiteti i grave në pushtet, ngritja e zërit kundër dhunës, pjesëmarrja aktive dhe masive e përkrahur nga komuniteti.

# 1. Qëllimi i manualit

Ky manual ka për qëllim të ofrojë udhëzime për të ndihmuar individët e verbër dhe me shikim të dobësuar që të lundrojnë dhe të kenë qasje në institucione dhe ngjarje të ndryshme kulturore në Kosovë. Duke zbatuar këto udhëzime, institucionet kulturore, organizatat jo - qeveritare që merren me çështje të ndryshme kulturore do të përmirësojnë qasjen dhe do të sigurojnë pjesëmarrjen dhe angazhimin e barabartë për këtë komunitet në ngjarjet kulturore.

Në këtë mënyrë do të sigurohet barazia sociale, do të arrihet zhvillimi personal si dhe edukimi i personave të verbër dhe me shikim të dobësuar. Qëllimi kryesor është që përmes këtij manuali të sigurohet përfshirje më e madhe e personave të verbër dhe me shikim të dobësuar në sferën e artit dhe kulturës duke e zgjeruar audiencën, por jo vetëm, dhe duke rritur ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë ndaj kësaj kategorie. Përveç zgjerimit të audiencës, synohet edhe ofrimi i mundësive për këtë kategori, që të shpalosin talentet e tyre artistike të cilat janë të shumta, dhe të merren me veprimtari artistike, varësisht kapaciteteve që posedojnë.

## Grupi i synuar

Ky manual është hartuar për përdorim për:

- ***Festivale Kulturore dhe Artistike***
- ***Organizata Jo-Qeveritare që Merren me Çështje Kulturore dhe Artistike***
- ***Institucione Kulturore që Veprojnë në Kosovë***
- ***Organizatrat që merren me personat me aftësi të kufizuara***
- ***Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim në Kosovë***
- ***Personat e Verbër dhe me shikim të dobësuar***

## 2. Vështrim i përgjithshëm dhe analizë e gjendjes ekzistuese e komunitetit të personave të verbër dhe me shikim të dobësuar

### Përkufizimi

Dobësimi i shikimit nënkupton vështirësinë e orientimit dhe vështirësinë në të lexuar. “Kushdo që ka vështirësi në lexim ose që ka vështirësi të orientohet me ndihmën e shikimit, ka dobësim të shikimit. Shumica e njerëzve mund të perceptojnë në mënyrë të dobët ngjyrat dhe objektet ose të shohin me një fushë vizioni shumë të kufizuar. Të tjerët kanë vështirësi kur është errësirë ose kur rrezet e diellit shkëlqejnë fort.”<sup>1</sup>

“Dëmtimi i shikimit ndodh kur një gjendje e caktuar e syrit ndikon në sistemin vizual dhe funksionet e tij të shikimit, duke lënë pasojë të rënda për individin gjatë gjithë jetës. Shkaqet kryesore të dëmtimit të shikimit dhe verbërisë në nivel global janë gabimet refraktive dhe kataraktet.”<sup>2</sup>

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në publikimin e muajit qershor 2024, rreth 1,849 (shifra varion nga muaji në muaj dhe nga viti në vit) persona janë të regjistruar në skemën e të verbërve.<sup>3</sup> Megjithatë, Shoqata e të Verbërve të Kosovës sugjeron se numri i personave të verbër dhe me shikim të dobësuar është shumë më i lartë, duke përmendur mbi 2,000 persona të verbër dhe rreth 3,000 persona me shikim të dobësuar, ku më shumë se gjysma kanë edhe paaftësi shtesë.<sup>4</sup>

### Sfidat dhe barrierat e qasshmërisë

Sfidat me të cilat përballlet kjo kategori në jetën e përditshme në vendin tonë janë të shumta dhe variojnë duke përfshirë faktorët social, mjedisor, dhe teknologjik.

Qasja e kufizuar në rrugë dhe sheshe publike - mungesa e pllakave taktile, pamundësia e përdorimit të transportit publik, sfidat në sektorin e edukimit si pasojë e mungesës së materialeve dhe mjeteve mësimore në alfabet Braille, punësimi, ndërveprimi social i kufizuar,

<sup>1</sup> <https://shvkosova.com/who-is-visually-impaired/>

<sup>2</sup> <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/blindness-and-visual-impairment>

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Mirëqenies Sociale Qershor 2024

<sup>4</sup> <https://shvkosova.com/who-is-visually-impaired/>



kufizime në marrjen e shërbimeve shëndetësore (mungesa e sinjalistikës adekuate dhe audio përshkrimit) deri te stigmatizimi dhe stereotipizimi. Të gjitha këto janë barrierë të cilat e pamundësojnë angazhimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet e përditshme, e rrjedhimisht edhe në ato kulturore a artistike.

Qasja në ngjarjet dhe institucionet e ndryshme kulturore, për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë është mjaft e limituar. Këtë e dëshmon hulumtimi i bërë në kuadër të “Doracakut për qasje në lokalitetet e trashëgimisë kulturore për persona me aftësi të kufizuara” të financuar nga MKRS. Në pyetjen se “Cila është arsyeja pse nuk e keni vizituar ndonjëherë ndonjë objekt të trashëgimisë kulturore? (shembull: muze, kullë, kala apo lokalitet arkeologjik), korrespondentët janë përgjigjur si mëposhtë:

52.9% - Nuk kam pasur informatë për objektin e trashëgimisë

47.1% - Nuk kam transport për të arritur te objekti

35.3% - Nuk kam si të hyjë në objekt

29.4% - Nuk kam si t'i vizitoj katet e objektit

23.5% - Nuk kam asistent për të më ndihmuar

23.5% - Ekspozitatet nuk janë të qasshme<sup>5</sup>

Sa i përket qasshmërisë për pjesëmarrje në ngjarje kulturore dhe artistike të personave të verbër dhe me shikim të dobësuar, në vendin tonë nuk ka fare elemente qasëse, fjala është për elemente themelore të cilat shërbejnë në qasjen, shfrytëzimin dhe orientimin e personave të verbër. Kjo sepse ka *infrastrukturë të papërshtatshme, mungesë të sinjalistikës, mungesë të udhëzuesve me zë, mungesë të materialeve në alfabetin Braille dhe përshkrimet audio*. Dy të fundit ju referohen:

1. *Programeve dhe materialeve të tjera artistike që nuk janë të disponueshme fare në alfabetin Braille, as në printim të fortë, as me zë. Kjo përfshin edhe librat, broshurat dhe materialet informuese që shpërndahen në teatër, muze, kinema dhe festivale.*

2. *Përshkrimet audio të shfaqjeve artistike, si filma, në teatro, që personave të verbër dhe me shikim të dobësuar t'u lejonin të kuptojnë dhe të shijojnë këto ngjarje.*

Adresimi i këtyre barrierave është thelbësor, për të siguruar që personat e kësaj kategorie të kenë mundësinë për të marrë pjesë dhe për të shijuar e përjetuar ngjarjet kulturore dhe

<sup>5</sup> “Doracaku për qasje të personave me aftësi të kufizuara në lokalitet të trashëgimisë kulturore”, MKRS-ChWB dhe Handikos, fq. 23

artistike në mënyrë të barabartë. Por nëse me kohë, pse jo dhe tani *Udhëzimi Administrativ – nr.33/2007 PËR KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA*<sup>6</sup> po të ishte prioritet i instucioneve shtetërore dhe po të ishte marrë seriozisht dhe të ishte zbatuar në të gjitha aspektet e tij, shumë nga barrierat që përballen komunitetet e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe personat e verbër dhe ata me shikim të dobësuar, do të ishin eliminuar ose minimizuar. Përmes zbatimit të plotë të këtij udhëzimi, qasja e barabartë në institucione publike dhe ngjarje kulturore do të ishte e garantuar, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës dhe pjesëmarrjen aktive të këtij komuniteti në shoqëri. Zbatimi i standardeve të përcaktuara për infrastrukturën dhe qasjen fizike është thelbësor për të siguruar një ambient gjithëpërfshirës, ku të gjithë qytetarët të kenë mundësinë të marrin pjesë në jetën publike dhe kulturore pa diskriminim apo pengesa.

## 3. Korniza ligjore

### Qasshmëria e barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuara

Në Kosovë, “legjislacioni vendor ndalon qartë diskriminimin bazuar në aftësinë e kufizuar. Sipas raportit të fundit të Avokatit të Popullit, edhe pse ekzistojnë ligje të veçanta që rregullojnë çështjet e personave me aftësi të kufizuara, ende mungon një ligj i harmonizuar gjithëpërfshirës që do të adresonte të gjitha grupet e këtyre personave.”<sup>7</sup>

Megjithatë, korniza ligjore dhe dokumentet strategjike në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara “janë të harmonizuara me dokumente ndërkombëtare, siç është Traktati i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UN CRPD) i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2006 dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian nga viti 2000.”<sup>8</sup>

### Në nivel shtetëror

1. **Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër**, rregullon gjendjen ligjore të personave të verbër në Republikën e Kosovës. Neni 11, paragrafi 1 i këtij ligji përcakton se, “Personave të verbër u mundësohet informimi në braille, në relief, shkrim të zmadhuar, si dhe në audio për të gjithë sinjalistikën në ambientet publike informacionet publike zyrtare, literaturën tekstet, dhe librat në të gjitha nivelet shkollore në bashkëpunim

<sup>6</sup> [www.gzk.rks-gov.net](http://www.gzk.rks-gov.net)

<sup>7</sup> “Doracaku për qasje të personave me aftësi të kufizuar në lokalitet të trashëgimisë kulturore”, MKRS-ChWB dhe Handikos, fq. 15

<sup>8</sup> “Doracaku për qasje të personave me aftësi të kufizuar në lokalitet të trashëgimisë kulturore”, MKRS-ChWB dhe Handikos, IBID

me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës.”<sup>9</sup> ndërsa Neni 12, paragrafi 3 i po këtij ligji, thekson se “Qeveria, në funksion të rehabilitimit dhe argëtimit të të verbërve, përkrah veprimtarinë kulturore të tyre dhe u siguron falas pjesëmarrjen në këto manifestime kulturore dhe sportive.”<sup>10</sup> Dhe, Neni 15, paragrafi 1 i po këtij ligji, thekson se “Institucionet përgjegjëse për miratimin e projekteve të infrastrukturës dhe rregullimin e territorit nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët dhe mjediset publike, nëse në to nuk janë marrë parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme për persona të verbër.”<sup>11</sup>

2. **Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi**, përcakton llojet e ndryshme të diskriminimit. Në “Nenin 4 të tij, përcaktohet qartë se mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike përbën diskriminim, përveçse kur është një barrë e paarsyeshme për personin që është i detyruar ta ofrojë dhe kjo nuk bie në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si përdorimi i burimeve të disponueshme publike, pjesëmarrjen në jetën sociale dhe publike dhe garantimin e qasjes në vendin e punës dhe kushte të përshtatshme pune.”<sup>12</sup>
3. **Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023**, është një dokument i rëndësishëm që synon përmirësimin e qasjes dhe barazisë për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Strategjia thekson rëndësinë e qasjes universale, duke bërë që produktet, shërbimet, ambientet dhe komunitetet të jenë të qasshme dhe të shfrytëzueshme nga të gjithë, pa nevojë për modifikime të veçanta. Në Objektivën Strategjike Nr 5, theksi vihet në krijimin e kushteve të barabarta për qasje, informim, komunikim dhe pjesëmarrje, si dhe në krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për personat me aftësi të kufizuara. Kjo objektivë synon të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të barabartë me të tjerët në ambientin fizik, transport, informacion dhe teknologji informative. Ky dokument përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të jetës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe përmbushjen e të drejtave të tyre bazuar në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në lidhje me sfidat për qasjen në eventet kulturore dhe artistike, kjo strategji mund të ndihmojë në adresimin e barrierave ekzistuese dhe promovimin e qasjes më të madhe për të gjithë, përfshirë edhe personat e verbër dhe me shikim të dobësuar.<sup>13</sup>

<sup>9</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, LIGJI NR. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR, Neni 11

<sup>10</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, LIGJI NR. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR, Neni 12

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, LIGJI NR. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR, Neni 15

<sup>12</sup> “Doracak u për qasje të personave me aftësi të kufizuara në lokalitet të trashëgimisë kulturore”, MKRS-ChWB dhe Handikos, fq. 16

<sup>13</sup> Qeveria, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023

**4. Strategjia për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore 2017-2027**, në kuadër të Objektivit 5-të thekson rëndësinë e edukimit, aftësimin dhe pjesëmarrjes aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore për të gjithë qytetarët. Edhe pse nuk i referohet drejtpërdrejt barrierave specifike që përballen personat me aftësi të kufizuara, strategjia përmend përmirësimin e “qasjes për të gjithë” si një të drejtë universale. Kjo përfshirje e konceptit të qasjes për të gjithë nënkupton se duhet të ndërmerren hapa konkretë për të siguruar që edhe personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta në përjetimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për përmirësimin e imazhit të Kosovës, jo vetëm brenda vendit, por edhe në nivel ndërkombëtar.<sup>14</sup>

## Në nivel ndërkombëtar

**1. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**, thekson në Nenin 30 të saj, “Një të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë njësoj si gjithë të tjerët në jetën kulturore të vendit dhe se do të marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që personat me aftësi të kufizuar:

- (a) *Gëzojnë qasje në materialet kulturore në të gjitha formatet e qasshme*
- (b) *Gëzojnë qasje në programet televizive, filma, teatro, dhe aktivitete të tjera kulturore, në formate të qasshme*
- (c) *Gëzojnë qasje në institucionet apo shërbimet kulturore, si p.sh: teatrot, muzeumet, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistë dhe për sa është e mundur të gëzojnë qasje në monumentet dhe qendrat me rëndësi për kulturën kombëtare”<sup>15</sup>*

Vitin e kaluar, edhe pse Kosova pati mundësinë që ta përfshijë në Kushtetutën e saj Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nuk e bëri këtë, ratifikimi i saj u la deri atëherë kur Kosova të bëhet anëtare me të drejta të plota në OKB.

<sup>14</sup> “Doracaku për qasje të personave me aftësi të kufizuar në lokalitet të trashëgimisë kulturore”, MKRS-ChWB dhe Handikos, fq. 18

<sup>15</sup> [www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd\\_albanian.pdf](http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf)

## 4. Rekomandime për mundësi të barabarta dhe gjithëpërfshirëse

Në Kosovë, edhe pse janë ndërmarrur disa nisma dhe ka pasur bashkëpunime në mes të Shoqatës së të Verbërve dhe me Shikim të Dobësuar të Kosovës me Muzeun Kombëtar të Kosovës, Muzeun në Gjakovë dhe Muzeut në Mitrovicë, sa i përket qasshmërisë në informim të komunitetit në këto institucione publike, është arritur për një pjesë të ekspozateve (ekspozateve më kryesore në muze) të bëhet përshkrimi në *harta prekëse* për vizitorët e këtij komuniteti. Por edhe pse janë hapa të rëndësishëm, mungesa e qasshmërisë fizike në këto institucione paraqet një pengesë të madhe për shfrytëzimin e plotë të këtyre resurseve nga komuniteti.

Njëherazi edhe Bibloteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” ka krijuar tanimë kushtet infrastrukturore për pjesën e shoqërisë së personave me aftësi të kufizuara. Ndërsa për komunitetin e të verbërve dhe atyre me shikim të dobësuar posedon një kabinet. Kabineti i posaçëm për komunitetin e të verbërve dhe atyre me shikim të dobësuar është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të qasshmërisë dhe mundësive për komunitetin që të kenë qasje në materiale dhe burime edukative dhe kulturore.

Qasshmëria është aspekti primar dhe me shumë rëndësi si në aspektin e përgjithshëm po ashtu dhe në atë të veçantë, e cila kërkon të mirret parasysh dhe të merren masa, nëse duam të zbatojmë parimin e gjithëpërfshirjes. Po të merren masat në praktikë, do kemi institucionet kulturore dhe artistike më të përfshira dhe më të qasshme për të gjithë qytetarët, duke siguruar që çdo individ të ketë mundësinë për të shijuar plotësisht jetën kulturore dhe artistike.

Madje jemi edhe dëshmitar se, një ndër barrierat për mosmundësi të barabartë, është mungesa e qasjes në ngjarje kulturore dhe artistike, sepse në teatrot, kinematë dhe festivalet në Kosovë, mungojnë sinjalet adekuate, përshkrimet audio, dhe programet në Braille, duke bërë shumë të vështirë për personat e verbër që të marrin pjesë dhe të përjetojnë këto aktivitete. Por, për të siguruar qasje infrastrukturore dhe informative të plotë dhe të barabartë kërkohet një planifikim i kujdesshëm dhe nevojitet të merren këto masa të veçanta:

## 4.1 Hapësirat

Hapësirat në objekte kërkohet të jenë të lehta për t'u arritur dhe të sigurojnë qasje të lehtë, për t'i ndihmuar personat e verbër dhe me shikim të dobësuar që të orientohen më lehtë dhe në mënyrë të pavarur.

*Udhëzim:*

Kërkohet që të përdoren hapësirat apo të bëhen ndërhyrjet e nevojshme në hapësira, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme për personat e verbër dhe me shikim të dobësuar. Për këtë qëllim, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- **Hapësira të Gjera për Lëvizje:** Hapësirat duhet të kenë korridore dhe ambiente të gjera për të lejuar lëvizjen e lirë dhe të sigurt.
- **Hapësira të Pastra nga Pengesat:** Të sigurohet që hapësirat të jenë të lira nga pengesat që mund të vështirësojnë lëvizjen.
- **Dyer Automatike me Butona të Qartë dhe të Arritshëm:** Dyer të pajisura me butona të mëdhenj, të ndritshëm dhe të pozicionuar në një lartësi të përshtatshme për t'u arritur lehtësisht.



Foto 1. Orientimi hapësinor gjithëpërfshirës për rekreacion / ©www.archdaily.com pengesat që mund të vështirësojnë lëvizjen.



Foto 2. Kombinimi i veçorive materiale dhe akustike në ndihmë të personave të verbër<sup>16</sup> /©www.cavagnero.com



Foto 3. Dysheme me shtigje taktile afër hyrjes/daljes<sup>17</sup>

<sup>16</sup> <https://www.re-thinkingthefuture.com/designing-for-typologies/a2660-10-great-examples-of-architecture-for-the-blind-around-the-world/>

<sup>17</sup> <https://www.inclusivitymaker.com/phygital-experience-accessibility-venue/>

## 4.2 Rrugët Hyrëse - Dalëse të Qarta:

- **Shtigjet Taktile:** Shtigje me pllaka të ngritura, shirita ose teksturë që ndihmojnë personat e verbër dhe me shikim të dobësuar, që të orientohen në mënyrë të pavarur deri te portat e detyrve.
- **Shenja dhe Sinjalizime të Dukshme:** Sinjalizime të dukshme dhe të qarta për të drejtuar personat me shikim të dobësuar
- **Ashensorë:** Sigurimi i ashensorëve për të ofruar qasje të lehtë në të gjitha katet e një ndërtese, me panele kontrolli të shënuara qartë dhe me opsione audio për t'u orientuar.

Për të përmirësuar qasjen dhe përdorshmërinë, është e rëndësishme që këto udhëzime të zbatohen në të gjitha hapësirat publike dhe private, duke përfshirë teatrot, kinematë, muzetë dhe vendet e tjera kulturore dhe arsimore.




Foto 4. Muzeu Gjithëpërfshirës<sup>18</sup> / <https://berlinischegalerie.de/en/berlinische-galerie/the-museum>

<sup>18</sup> [www.berlinischegalerie.de/en/berlinische-galerie/the-museum](https://berlinischegalerie.de/en/berlinische-galerie/the-museum)



### 4.3 Sinjalistika e qartë për orientim

Udhëzim:

Hapësirat e brendshme në objekte duhet të kenë të vendosur sinjalistikë të qartë për orientim.

Për shembull:

- Sinjalistika përfshin shenja të mëdha, me kontrast të lartë, me tekst të thjeshtë dhe të theksuar, dhe simbole universale që tregojnë vendndodhjen si “Hyrja” dhe “Dalja”.
- Këto shenja duhet të pozicionohen në nivelin e syve.
- Shenjat duhet të përfshijnë alfabetin Braille për ata që janë plotësisht të verbër.
- Tabela me alfabet Braille dhe kontrast të lartë kryejnë të njëjtin funksion.

**Shembull:**




Foto 5. Shembull se si duhet të duket teksti për personat me shikim të dobësuar<sup>19</sup>

<sup>19</sup> Font Legibility for Students who are Blind or Visually Impaired - Teaching Students with Visual Impairments (teachingvisuallyimpaired.com)

## **Përfitimet e Sinjalistikës së Qartë për Orientim**

### **1. Rritja e Qasjes:**

- *Sinjalistika e qartë dhe e lexueshme bën që objektet të jenë më të qasshme për të gjithë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.*

### **2. Lehtësimi i Lëvizjes:**

- *Shenjat e pozicionuara në nivelin e syve dhe me kontrast të lartë ndihmojnë në orientimin e lehtë të të gjithë vizitorëve.*

### **3. Siguria e Shtuar:**

- *Duke pasur sinjalistikë të qartë dhe të lexueshme, rritet siguria në raste emergjente, duke bërë që daljet dhe hyrjet të jenë lehtësisht të identifikueshme.*

### **4. Përfshirja Sociale:**

- *Përdorimi i alfabetit Braille në sinjalistikë promovon përfshirjen sociale të personave të verbër, duke siguruar që ata të kenë të njëjtin nivel informacioni si të gjithë të tjerët.*

## **Këshilla për Zbatim**

- *Përzgjedhni materiale të qëndrueshme dhe të lehta për t'u mirëmbajtur për sinjalistikën.*
- *Konsideroni përdorimin e ndriçimit adekuat për të siguruar që sinjalistika të jetë e dukshme edhe në kushte të ulëta ndriçimi.*
- *Angazhoni profesionistë të dizajnit dhe ekspertë të qasshmërisë për të siguruar që sinjalistika të jetë efektive dhe e përputhshme me standardet e fundit të qasshmërisë.*

*Zbatimi i sinjalistikës së qartë për orientim është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një mjedisi të qasshëm dhe përfshirës për të gjithë.*

## 4.4 Udhëzues Zëri

**Udhëzim:** Udhëzuesi i zërit është një mjet tepër i dobishëm për drejtimin e njerëzve përmes hapësirave brenda objekteve. Nëse lejohet dhe është e mundur të bëhen ndërhyrje, rekomandohet instalimi i udhëzuesve të zërit. Këta udhëzues mund të ndihmojnë në mënyrat e mëposhtme:

- **Orientimi i Vizitorëve:** Udhëzuesit e zërit mund të japin udhëzime të qarta dhe të sakta për të drejtuar njerëzit në destinacionet e tyre të dëshiruara brenda hapësirës. Kjo mund të përfshijë informacion për drejtimin, distancën dhe ndonjë pengesë që mund të haset gjatë rrugës.
- **Informacion i Detajuar:** Udhëzuesit e zërit mund të japin informacion të detajuar rreth objekteve dhe shërbimeve të ofruara, duke ndihmuar kështu vizitorët të kenë një përvojë më të plotë dhe më të këndshme.
- **Përdorim i Lehtë:** Këta udhëzues zakonisht janë të thjeshtë për t'u përdorur dhe mund të aktivizohen me prekje ose me komandë zanore, duke e bërë atë të qashtëm për të gjithë, përfshirë individët me aftësi të kufizuara.
- **Siguri e Shtuar:** Duke udhëzuar njerëzit në mënyrë të saktë dhe të qartë, udhëzuesit e zërit mund të kontribuojnë në një mjedis më të sigurt, duke reduktuar mundësinë e humbjes ose aksidenteve brenda hapësirave të mëdha apo komplekse.

Këto sisteme mund të jenë veçanërisht të dobishme në muze, teatro, kinema, qendra tregtare, aeroporte dhe në çdo vend tjetër ku orientimi i saktë është i rëndësishëm për një përvojë të mirë të vizitorëve.

## 4.5 Ulëse të Qashme

**Udhëzim:** Në çdo organizim të ngjarjeve kulturore dhe artistike, gjithmonë duhet ta kemi parasysh se personat e verbër dhe me shikim të dobësuar duhet të sistemohen në hapësira ku ulëset janë lehtë të qashme. Këto hapësira duhet të jenë pranë hyrjes për të mundësuar hyrje/dalje më të lehta. Për ngjarjet kulturore me program të organizuar, duhet të caktohen hapësira të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

## 4.6 Audio Përshkrimi i ngjarjeve të ndryshme kulturore

**Udhëzim:** Personave të verbër dhe me shikim të dobësuar, për t'ju krijuar mundësi të barabartë për të përjetuar ngjarje të ndryshme kulturore dhe artistike, duhet t'u merren masa për të ofruar shërbimin e përshkrimit audio.

Audio përshkrimi mundëson që individët e verbër dhe ata me shikim të dobësuar të ndjekin ngjarje kulturore apo sportive si festivalet, filmat, teatrin, artin, futbollin etj. Kjo formë e komunikimit përshkruan me anë të zërit gjërat e vizualizuara, duke përfshirë mjediset, veshjet dhe shprehjet e fytyrës. Interpretuesi zgjedh të përshkruajë atë që është e dukshme dhe e rëndësishme për ngjarjen.

Audio përshkrimi mund të aplikohet edhe nëpër galeri të artit. Audio përshkrimet duhet të jenë të detajuara, duke përshkruar verbalisht elementet vizuale, kontekstin dhe qëllimin e artistit. Kjo mund të bëhet nëpërmjet tureve të drejtuara ose udhërrëfyesve audio të disponueshëm në ngjarje.



Foto 6. Publiku me shikim të dobësuar dhe me shikim të ulët përjetojnë një shfaqje teatrale përmes përshkrimit audio të drejtpërdrejtë në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit të Nepalit 2022.<sup>20</sup>

<sup>20</sup> Beyond the Norm: A Guide to Inclusive Events

## 4.7 Shkronja të Zmadhuara

Është shumë e rëndësishme që aktorët e fushës së kulturës dhe artit në Kosovë, përfshirë festivalet, organizatat joqeveritare dhe institucionet, të marrin parasysh nevojat e të gjithë qytetarëve dhe të ndërmarrin iniciativa për të siguruar që programet artistike dhe materialet përcjellëse të ngjarjeve kulturore dhe artistike të jenë të qasshme për të gjithë.

**Udhëzim:** Kjo i referohet tekstit që printohet në një font më të madh shkronjash, në krahasim me tekstin standard. Përdorimi i një fonti më të madh mund ta bëjë më të lehtë leximin për ata me shikim të dobësuar ose vështirësi të tjera në lexim,p.sh. kur ofrohet një program ngjarjeje.

**Shembull:** Festivali FemArt në edicionin e tij të njëmbëdhjetë ka bërë një hap para sa i përket qasshmërisë në materiale për personat e verbër dhe me shikim të dobësuar, ku programin e edicionit 11 të Festivalit e ka prezentuar edhe në alfabet Braille dhe në font të madh (font 20) të shkronjave dhe po ashtu ka përpiluar edhe një udhëzues për nevojat të brendëshme të Festivalit.




Foto 7. Program i edicionit të 11 të Festivalit FemArt (2023) i prezentuar në alfabet Braille dhe në font të madh (font20).

Për të krijuar qasje dhe përfshirje në programe artistike dhe materiale të tjera, është e rëndësishme që festivalet, organizatat joqeveritare dhe institucionet të ndërtojnë raporte dhe marrëdhënie bashkëpunimi me Shoqatat e Personave të Verbër dhe me Shikim të Dobësuar në Kosovë, si dhe me Shoqatën Ndërkomunale të të verbërve në Pejë, e me Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim (shkolla e arsimit special) “Xheladin Deda” në Pejë.

Kjo qasje ndihmon në sigurimin e përfshirjes së këtyre grupeve në aktivitete kulturore dhe artistike, duke u ofruar mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në jetën kulturore.

## 4.8 Ekspozita Taktile

Krijimi i kushteve për organizimin e Ekspozitave Taktile në muzetë dhe galeritë e Kosovës është një hap i rëndësishëm drejt përfshirjes së komunitetit të personave të verbër dhe me shikim të dobësuar në aktivitete kulturore dhe artistike.

### Çka janë ekspozitat taktile?

**Udhëzim:** Ekspozitat taktile realizohen duke përfshirë replika taktile ose modele të veprave të caktuara artistike. Replikat duhet të jenë të sigurt dhe lehtë të qasshme, duke i lejuar pjesëmarrësve t'i prekin dhe t'i eksplorojnë teksturat, format dhe aspekte të tjera fizike të artit. Këto ekspozita ofrojnë mundësinë që ata të marrin pjesë në ekspozita kolektive apo personale dhe të vlerësojnë artin përmes shqisave të tjera.



Foto 8. Vizitorët janë në gjendje të ndjejnë veprën e Pieter Brueghel dhe Leonardo da Vincit. Burimi: Valentin Haüy-Bruksel <sup>21</sup>

<sup>21</sup> <https://www.brusselstimes.com/784474/tactile-tour-art-exhibition-for-blind-and-visually-impaired-comes-to-brussels>

## 4.9 Webfaqe e Qasshme

Sigurimi i qasjes në informata për aktivitetet kulturore dhe artistike për personat e verbër dhe me shikim të dobësuar është jetik për përfshirjen e tyre në jetën kulturore të Kosovës. Krijimi i uebfaqeve të qasshme është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim.

**Udhëzim:** Faqja e internetit duhet të jetë e navigueshme duke përdorur vetëm një tastierë, me një renditje logjike të skedave dhe tregues të qartë të fokusit. Gjithashtu, duhet të përfshijë përshkrimet audio për videot. Teksti duhet të ketë kontrast të lartë me sfondin dhe të lejojë rregullime të madhësisë së tekstit për personat pjesërisht të verbër.

**Shembull:** Webfaqe të qasshme kemi webfaqen e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, [www.kdf-ks.org](http://www.kdf-ks.org)

Institucionet kulturore, organizatat joqeveritare dhe ofruesit e shërbimeve digjitale në Kosovë duhet të bashkëpunojnë për të siguruar që informacioni për aktivitetet kulturore dhe artistike të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët, përfshirë personat e verbër dhe me shikim të dobësuar. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi kulturor më gjithëpërfshirës dhe më të drejtë për të gjithë.

## 4.10 Hapësirë e Qetë (Zona Pushimi)

**Udhëzim:** Përcaktimi i një zone të qetë ose pushimi brenda një ngjarjeje kulturore (koncert, festival apo shfaqje më e gjatë) është thelbësore për pjesëmarrësit me ndjeshmëri shqisore të cilët mund të kenë nevojë për një pushim nga mbi-stimulimi i mundshëm. Kjo hapësirë duhet të jetë e qetë dhe e qasshme, duke ofruar një tërheqje nga mjedisi i ngarkuar.

Foto 9. Hapësirë e qetë ne Diverse Festival, MB/ <https://www.diverseuk.org/sensory-calm-space/>



## 4.11 Ndhimja dhe Shërbimet e Ndhimës

Për të përmirësuar qasjen e personave të verbër dhe ata me shikim të dobësuar në ngjarjet kulturore dhe artistike në Kosovë, ofrimi i ndihmës dhe shërbimeve mbështetëse është thelbësor.

Udhëzim:

### Asistentët Personal

- Disponueshmëria e Asistentëve Personal:
  - Institucionet kulturore dhe artistike duhet të sigurojnë që individët me shikim të dobësuar të kenë qasje në asistentë personale gjatë ngjarjeve.
  - Këta asistentë mund të ndihmojnë me orientimin në hapësirat e ngjarjeve, shpjegimin e detajeve vizuale dhe navigimin e shërbimeve të tjera të nevojshme.

### Trajnimi i Stafit

Stafi i institucioneve duhet të trajnohet në mënyrë që të jenë në gjendje të ndihmojnë dhe t'iu përgjigjen nevojave të personave të verbër dhe të atyre me shikim të dobësuar.

Trajnimi duhet të përfshijë:

- Kuptimin e sfidave me të cilat përballen personat e verbër dhe ata me shikim të dobësuar.
- Aftësinë për të komunikuar qartë dhe me respekt.
- Përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe burimeve të tjera mbështetëse.
- Njohjen e protokolleve për situata emergjente që përfshijnë personat e verbër dhe ata me shikim të dobësuar.

Zbatimi i këtyre masave do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të qasshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë pjesëmarrësit në ngjarje kulturore dhe artistike.

## 4.12 Teknologjia e Përshtatshme

Përmirësimi i përvojës së vizitorëve të verbër dhe me pamje të kufizuara në ngjarjet kulturore dhe artistike në Kosovë mund të arrihet përmes përdorimit të mjeteve ndihmëse teknologjike.



Udhëzim:

## 1. Pajisjet e Përshkrimit Audio

**Përshkrimi:** Këto pajisje ofrojnë përshkrime të detajuara të ngjarjeve, ekspozitave ose performancave, duke përdorur audio.

### Udhëzime për Përdorim:

- **Përgatitja e Materialeve:** Organizatorët e ngjarjeve duhet të krijojnë përshkrime audio të përgatitura mirë për çdo pjesë të veprës, duke përfshirë detajet rreth artit, artistëve dhe kontekstit historik.
- **Qasja e Lehtë:** Pajisjet duhet të jenë lehtësisht të qasshme për vizitorët, duke i ofruar ato në hyrje ose nëpërmjet aplikacioneve të dedikuara.
- **Trajnimi i Stafit:** Stafi duhet të trajnohet për të ndihmuar vizitorët në përdorimin e pajisjeve dhe për t'u siguruar që ata të kenë një përvojë të këndshme.




Foto 10. Një vizitor i galerisë duke përdorur Stilolapsin Discovery në Butler Gallery, Kilkenny<sup>22</sup>

<sup>22</sup> <https://adiarts.ie/audiences/access-the-arts/audio-description/>

## 2. Aplikacionet e Telefonave të mençur

**Përshkrimi:** Aplikacionet e smartfonëve mund të ofrojnë përmbajtje të personalizuar, përshkrime audio dhe udhëzime për vizitorët.

### Udhëzime për Përdorim:

- **Krijimi i Aplikacioneve:** Organizatorët duhet të zhvillojnë aplikacione që ofrojnë mundësi për përshkrim audio, si dhe hartat interaktive për të orientuar vizitorët.
- **Integrimi me Teknologjinë e Ndhmës:** Aplikacionet duhet të jenë të përputhshme me teknologjitë e tjera si lexuesit e ekranit, për të siguruar qasje për ata që kanë nevoja të veçanta.
- **Përditësime të Rregullta:** Mbani aplikacionet të përditësuar me përmbajtje të reja dhe informacione mbi ngjarjet, si dhe përmirësime në funksionalitet.

## 4.13 Hartat Prekëse

**Përshkrimi:** Hartat prekëse janë një mjet i shkëlqyer për të ndihmuar vizitorët që të kuptojnë hapësirat fizike dhe vendndodhjet në një ngjarje.

### Udhëzime për Përdorim:

- **Krijimi i Hartave Prekëse:** Hartat duhet të përfshijnë simbole të thjeshta dhe të qarta për të përfaqësuar vendndodhjet kryesore dhe objektet brenda hapësirës.
- **Vendosja Strategjike:** Sigurohuni që hartat të vendosen në vende të lehta për t'u arritur, si në hyrje dhe në pika të ndryshme të ngjarjes.
- **Trajnimi i Stafit:** Stafi duhet të jetë i trajnuar për të ndihmuar vizitorët që të interpretojnë hartat dhe të ofrojnë informacion të nevojshëm.



Foto 11. Një fëmijë duke përdorur hartën taktile/ *linearclassifier*.

#### 4.14 Teknologjia e Realitetit të Shtuar (AR)

**Përshkrimi:** Realiteti i shtuar mund të ofrojë përvoja interaktive që ndihmojnë vizitorët të eksplorojnë ngjarjet në mënyrë më të angazhuar.

##### Udhëzime për Përdorim:

- **Zhvillimi i Aplikacioneve AR:** Krijoni aplikacione që përdorin AR për të ofruar informacione shtesë dhe përshkrime për artin dhe performancat.
- **Integrimi me Qasjen:** Sigurohuni që aplikacionet AR të jenë të përputhshme me teknologjitë ndihmëse si lexuesit e ekranit.
- **Krijimi i Eksperiencave Unike:** Mund të ofrohet përmbajtje AR që është e dizajnuar për të angazhuar vizitorët dhe për t'i ndihmuar ata që të kuptojnë më mirë punën artistike.<sup>23</sup>

Përdorimi i këtyre teknologjive ndihmëse mund të ndihmojë në krijimin e një ambienti më të hapur dhe përfshirës për vizitorët e verbër dhe me pamje të dobësuar. Organizatorët e ngjarjeve duhet të angazhohen që nevojat e të gjithë vizitorëve janë të përmbushura, duke krijuar një përvojë kulturore të pasur dhe të qasshme për të gjithë.

<sup>23</sup> <https://www.museumnext.com/article/making-museums-accessible-to-visually-impaired-visitors/>

## 5. Përmbledhje e rekomandimeve për grupet e synuara

Rekomandimet	Grupet e synuara
<b>Hapësirat e qasshme</b>	Institucionet kulturore në përgjithësi, festivalet e ndryshme
<b>Rrugët Hyrëse - Dalëse të Qarta:</b>	Institucionet kulturore në përgjithësi, festivalet e ndryshme
<b>Sinjalistika e qartë për orientim</b>	Institucionet kulturore në përgjithësi, festivalet e ndryshme
<b>Udhëzues Zëri</b>	Galeritë, Teatrot, Festivalet e ndryshme
<b>Ulëse të Qasshme</b>	Teatrot, Festivalet e ndryshme
<b>Audio Përshkrimi i ngjarjeve të ndryshme kulturore</b>	Teatrot, Galeritë, Festivalet e ndryshme kulturore
<b>Shkronja të Zmadhuara</b>	Galeritë, Festivalet, Teatrot
<b>Ekspozita Taktile</b>	Galeritë
<b>Webfaqe e Qasshme</b>	Institucionet kulturore në përgjithësi, Festivalet
<b>Hapësirë e Qetë (Zona Pushimi)</b>	Festivalet, Institucionet kulturore në përgjithësi
<b>Ndihma dhe Shërbimet e Ndihmës</b>	Festivalet, Teatrot
<b>Teknologjia e Përshtatshme</b>	Institucionet kulturore në përgjithësi, Festivalet
<b>Hartat Prekëse</b>	Galeritë, Festivalet
<b>Teknologjia e Realitetit të Shtuar (AR)</b>	Teatrot, Muzeu, Festivalet

## 6. Shembuj të suksesshëm nga rajoni dhe bota

Vende të ndryshme të Rajonit kanë marrë nisma të ndryshme sa i përket qasshmërisë së personave të verbër dhe me shikim të dobësuar në ngjarje kulturore. Më poshtë janë të listuara disa nga to, nga të cilat ne si shtet mund të inspirohemi dhe ta ndjekim shembullin e tyre:

- **Muzeu Kombëtar i Slovenisë:** Po plotëson gradualisht koleksionet e përhershme historike dhe të artit në Metelkova me elemente që i bëjnë ekspozitat më të qasshme për vizitorët e verbër dhe me shikim të dobësuar. Ekspozita e Rudolf Cvjetko, e cila prezantoi olimpinistin e parë të vendit, u prezantua me kopje të cilat vizitorët mund t'i prekin dhe ndjejnë, me legjenda në Braille.<sup>24</sup>
- **Muzeu Kombëtar i Serbisë dhe Muzeu i Shkencave të Natyrës:** Organizojnë ekspozita taktile për personat e verbër. Qasshmëria ishte një nga kriteret për projektet që u prezantuan në Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Beograd dhe nga viti 2005 deri në 2007 një ekspert me aftësi të kufizuara ka qenë anëtar i komitetit organizativ të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Beograd.<sup>25</sup>
- **Teatri Kombëtar në Angli** ka krijuar Skemën për Qasshmëri e cila u jep mundësi personave me probleme në të dëgjuar, personave me aftësi të kufizuara dhe neurodivergjentë të regjistruhen në mënyrë që të rezervojnë vendet e tyre dhe të shoqëruesve të tyre. Gjithashtu, ata kanë hartuar programin e performancave të asistuara përmes pajisjeve të ndryshme të cilat mundësojnë përjetimin e shfaqjeve për personat me aftësi të kufizuara.<sup>26</sup>
- **Në Sllovaki**, përveç Programit Kultura për Personat me Aftësi të Kufizuara, Ministria e Kulturës ka gjithashtu programe të tjera të cilat i subvencionon e që lehtësojnë qasjen në kulturë për të verbërit - në veçanti, programin e subvencionimit të Aktiviteteve Kulturore në Depot e Dijes Publike, Bibliotekat dhe nën-programet e Aktiviteteve të Bibliotekave dhe - programin e subvencionimit të Kuponëve Kulturor – i cili mund të përfshijë shkolla speciale (p.sh. shkolla për fëmijë dhe të rinj të verbër, artistë të verbër ose me aftësi të kufizuara që prezantojnë programet

<sup>24</sup> Access for People with Disabilities to Culture, Tourism, Sports and Leisure Activities: Towards Meaningful and Enriching Participation- Mr Damjan TATIC Council of Europe, 2015, fq 68

<sup>25</sup> Access for People with Disabilities to Culture, Tourism, Sports and Leisure Activities: Towards Meaningful and Enriching Participation- Mr Damjan TATIC Council of Europe, 2015, fq 65

<sup>26</sup> <https://www.nationaltheatre.org.uk/your-visit/access/>

e tyre). Sistemi i subvencionimit të Fondit Audiovizual mbështet komentimet audio dhe titrat për veprat audiovizive.<sup>27</sup>

- **Galeria Kombëtare e Pragës** u ofron vizitorëve të verbër dhe me shikim të dobësuar një përvojë VR që i lejon ata të “prekin” tre nga kryeveprat më të mëdha skulpturore në botë. Me doreza haptike, vizitorët e verbër dhe me shikim të dobësuar mund të eksplorojnë me prekje kopjet VR të Kokës së Nefertitit, Venera e Milos dhe Davidit të Michelangelos, duke i lejuar ata që të përjetojnë për herë të parë veprat e artit.<sup>28</sup>
- **“Ngjyra që unë prek”** është një program edukativ për fëmijët e verbër i organizuar nga Istanbul Modern. Programi përbëhet nga turne ekspozitash të udhëhequra nga ekspertë, seminare dhe shfaqje filmash të përshkruara audio për t’i prezantuar fëmijët me artin dhe për t’u dhënë atyre një mundësi për ta eksploruar dhe interpretuar atë. “Ngjyrat që unë prek” ofrohet falas për fëmijët e verbër.<sup>29</sup>
- **Muzeu Taktil i Athinës:** Qëllimi i Muzeut Taktil në Athinë, i krijuar nga Lighthouse për të Verbërit e Greqisë, ishte të gjente një mënyrë që njerëzit e verbër dhe me shikim të ulët të shijonin veprën e artit të lashtë grek. Të gjitha pjesët e muzeut janë kopje të origjinaleve që gjenden në muzetë e tjerë anembanë vendit dhe të gjitha pjesët mund të përjetojnë me prekje.<sup>30</sup>
- **Në Suedi** Riksteatern Crea ka prodhuar arte performuese në gjuhën e shenjave, me dhe nga artistë të shurdhër dhe artistë të gjuhës së shenjave dhe artistë kulturor të shurdhër, dhe të gjuhës së shenjave që nga vitet 1970. Prodhimi i tyre aktual i Shtëpisë së Kukullës, me një kastë prej 3 aktorësh të shurdhër dhe 1 dëgjues, përdor gjuhën suedeze të shenjave si gjuhë parësore.<sup>31</sup>

<sup>27</sup> Access for People with Disabilities to Culture, Tourism, Sports and Leisure Activities: Towards Meaningful and Enriching Participation- Mr Damjan TATIC Council of Europe, 2015, fq 66

<sup>28</sup> <https://www.bemyeyes.com/blog/10-accessible-art-and-museum-experiences>

<sup>29</sup> <https://www.bemyeyes.com/blog/10-accessible-art-and-museum-experiences>

<sup>30</sup> <https://www.bemyeyes.com/blog/10-accessible-art-and-museum-experiences>

<sup>31</sup> Report from the IETM Belgrade Plenary Meeting, Work & disability in the arts from the IETM Belgrade Plenary Meeting, By Fanny Martin

- **Performancat e qeta:** Të quajtura gjithashtu «Performanca të relaksuara» ose «Performanca miqësore ndaj shqisave». Shfaqjet e relaksuara fillimisht u krijuan për të bërë shfaqje më të qasshme për personat me aftësi të kufizuara sipas rregullave të zakonshme të mirësjelljes në teatër. Parimet e këtyre performancave janë qartësia, informacione të kuptueshme, dhe qasje e relaksuar e levizjeve të qeta dhe zhurmës që vjen nga publiku.<sup>32</sup>
- **Modeli social i aftësisë së kufizuar:** Sipas Modelit Social, aftësia e kufizuar është përshtatur si një konstrukt social krijuar nga barriera të cilat mund të ndryshohen dhe eliminohen, duke siguruar një model dinamik dhe pozitiv i cili identifikon shkaqet e përjashtimit dhe pabarazisë dhe propozon një zgjidhje. I takon shoqërisë që të bëjë ndryshimet, jo personit me aftësi të kufizuara; për individë dhe organizata për të kuptuar dhe më pas për të bërë rregullimet e nevojshme për të ndaluar marginalizimin dhe përjashtimin e njerëzve, trupat dhe mendjet e të cilëve nuk janë në përputhje me idenë e shoqërisë për atë që është normative dhe e pranueshme.<sup>33</sup>

<sup>32</sup> Report from the IETM Belgrade Plenary Meeting, Work & disability in the arts from the IETM Belgrade Plenary Meeting, *By Fanny Martin*

<sup>33</sup> Report from the IETM Belgrade Plenary Meeting, Work & disability in the arts from the IETM Belgrade Plenary Meeting, *By Fanny Martin*

## Përfundim

Duke i ndërthurur këto elemente, ky doracak mund të shërbejë si një burim praktik dhe fuqizues, duke siguruar që individët me shikim të dobësuar dhe të verbër të kenë mundësi të marrin pjesë dhe të shijojnë ngjarjet kulturore. Përmes përdorimit të këtij doracaku, synohet përmbushja e kërkesave ligjore për gjithëpërfshirje, si dhe nxitja e mundësisë që të gjithë qytetarët, pa dallim, të jenë pjesë e artit dhe kulturës. Një qëllim tjetër i rëndësishëm është që, përmes aplikimit të rekomandimeve të këtij manuali, Republika e Kosovës të shërbejë si një model i gjithëpërfshirjes në ngjarjet kulturore, duke u bërë shembull për vendet e tjera që nuk kanë ende një model të tillë. Ky doracak do të jetë një udhërrëfyes për planifikimin e organizimeve të ndryshme, si festivalet, shfaqjet teatrale, ekspozitat, etj. Për më tepër, përdorimi dhe zbatimi i këtij manuali do të nxisë rritjen e vetëdijes për të drejtat e pjesëmarrjes në ngjarjet kulturore, për të gjithë, përfshirë edhe kategoritë me aftësi të kufizuara. Përfshirja në këto ngjarje pasuron mendjen dhe shpirtin, dhe përjetimi i veprave kulturore dhe artistike duhet të jetë i arritshëm për këdo, kudo dhe çdoherë.



## Bibliografia

1. “Doracaku për qasje të personave me aftësi të kufizuar në lokalitet të trashëgimisë kulturore”, MKRS-ChWB dhe Handikos.
2. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, LIGJI NR. 04/L – 092 PËR PERSONAT E VERBËR.
3. Qeveria, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023.
4. Beyond the Norm: A Guide to Inclusive Events.
5. Access for People with Disabilities to Culture, Tourism, Sports and Leisure Activities: Towards Meaningful and Enriching Participation- Mr Damjan TATIC Council of Europe, 2015.
6. Font Legibility for Students who are Blind or Visually Impaired - Teaching Students with Visual Impairments (teachingvisuallyimpaired.com).
7. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Mirëqenies Sociale.

### Linqe:

1. <https://shvkosova.com/who-is-visually-impaired/>
2. <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/blindness-and-visual-impairment>
3. <https://www.bemyeyes.com/blog/10-accessible-art-and-museum-experiences>
4. <https://www.museumnext.com/article/making-museums-accessible-to-visually-impaired-visitors/>
5. <https://www.re-thinkingthefuture.com/designing-for-typologies/a2660-10-great-examples-of-architecture-for-the-blind-around-the-world/>
6. <https://shvkosova.com/who-is-visually-impaired/>
7. [www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd\\_albanian.pdf](http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf)
8. <https://www.brusselstimes.com/784474/tactile-tour-art-exhibition-for-blind-and-visually-impaired-comes-to-brussels>

**artpolis**  art and  
community  
center

**Donatorët:**



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
ZYRA E PRESIDENTES**

**JOSEPH  
HANDLEMAN  
"I BELIEVE IN YOU"  
FOUNDATION. (USA)**



## **Kontaktet**

Adresa: Mujo Ulqinaku no. 8/8, 10000 Prishtina

Tel: + 383 38 221 512

E-mail: [ojq.artpolis@gmail.com](mailto:ojq.artpolis@gmail.com)

F: <https://www.facebook.com/artpolisKosovo/>

I: <https://www.instagram.com/artpoliscenter/>

T: <https://twitter.com/qendraartpolis?lang=en>